



UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare
Nr. 02-47/08-07
Prishtinë, më 22 mars 2007, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.
Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 81 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i informatës së Autoritetit Rregulllatot të Telekomunikacionit lidhur me përgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë.
2. Shqyrtimi i informatës për ngjarjet e 10 shkurtit 2007.

1. Shqyrtimi i informatës së Autoritet Rregullator të Telekomunikacionit lidhur me përgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë

Kryetari i informoi deputetët për përfundimin e sëancës plenare të 16 marsit 2007 që gjatë shqyrtimit të informatës së Autoritetit Rregulator të Telekomunikacionit për përgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë, Kuvendi kishte shtyrë debatin për këtë pikë dhe kishte kërkuar nga Bordi i ART-së që t'i paraqiste Kuvendi të dhënat shtesë për pjesëmarrësit në tender dhe vlerësimet e pikave ofertuesve lidhur me procedurën për zgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë, si dhe në seancën plenare të 22 marsit 2007 të marrin pjesë kryeministri i Kosovës, ministri për Telekomunikacion, kryesuesi i ART-së dhe të gjithë anëtarët e bordit. Informata shtesë u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Ai e ftoi kryesuesin e ART-së ta merrte fjalën.

Anton Berisha, kryesues i Bordit të ART-së tha se u jemi përgjigjur të gjitha kërkesave të Kuvendit dhe të Komisionit Funksional. Më 6 shkurt 2007 kemi raportuar për këtë temë

Zhvillimi i sektorit të telekomunikacionit në Kosovë është i një rëndësie të madhe për ekonominë dhe shoqërinë kosovare si tërsi, prandaj është e domosdoshme të krijohet tregu konkurrent në mes operatorëve të licencuar.

Sipas nenit 36 të Ligjit për telekomunikacion Ministria e ka përgatitur pakon tenderuese, ndërsa ART i ka zbatuar procedurat tenderuese për operatorin e dytë të telefonisë mobile në Kosovës.

Qeveria e Kosovës ka përcaktuar metodën e përgjedhjes së kombinuar të ashtuquajtura Ankant + Bjuti kontest si dhe kriteret e vlerësimit, në të cilin është përcaktuar që çmimi të jetë 30% të pikëve, mbulueshmëria dhe shtrirja e rrjetit 30%, participimi vendor 20%, shërbimet dhe kualiteti 10%, përvoja në telefoninë mobile 10% si dhe çmimi minimal prej 20 milionë eurosh.

Përgjegjësitë e ART-së, Komisioni Special mbikëqyrës është udhëhequr nga përfaqësuesi i Qeverisë, ndërsa Komisionit i është kërkuar, që gjitha vendimet t'i marrë me konsensus, pranuk ka pasur sistem të votimit. Përgjegjësia e ART-së në këtë proces ka qenë e natyrës administrative dhe profesionale. Ministria e Transporti dhe e Post - telekomunikacionit dhe ART kanë bërë publikimin e tenderit në shtypin vendor dhe në shtypin ndërkombëtar.

Komisioni për vlerësimin e ofertave është themeluar nga dy anëtarë të emëruar nga PSSP-ja një anëtar nga Zgjedhja e kryeministrit dhe dy anëtarë nga ART-ja.

Në ditën e nënshkrimit të licencës, si përfaqësues i ART-së kam takuar zëvendës kryeadministratorin z. Shuk dhe për UNMIK-un kjo çështje është e mbyllur. Po të njëjtën ditë kryeministri i Kosovës, z. Agim Çeku, në emër të Qeverisë ka nënshkruar deklaratën e vendimit për licencim.

Ky proces është i dobishëm për ekonominë dhe qytetarët e Kosovës. Janë bërë përparime të dukshme në sektorin e telekomunikacionit në Kosovë.

Kryetari e ftoi kryeministrin e Kosovës ta merrte fjalën.

Kryeministri **Agim Çeku** tha se rolin e Qeverisë gjatë këtij procesi ka qenë rezultat pozitiv. Kjo është përpjekja e dytë e përzgjedhjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile. Kemi pasur një proces, në të cilën ART-ja e ka publikuar fituesin e tenderit të parë, i cili është anuluar nga UNMIK-u, që ka shprehur dyshimin se procesi ka qenë i parregullt. Pastaj Qeveria mori vendim që të fillojë ritenderimi i këtij procesi. Para se të shpallet tenderi kemi angazhuar një kompani konsulente ndërkombëtare STER-com nga Suedia, e cila së bashku me Ministrinë e Transportit ka qenë e ngarkuara ta përgatitë pakon tenderuese dhe të përcaktojë kriteret dhe metodat e vlerësimit.

Më 7 korrik 2006 Ministria e Transportit dhe e Post-Telekomunikacionit mori vendim për themelimin e Komisionit mbikëqyrës, pa të drejtë vendimmarrjeje, i përbërë nga përfaqësuesit e Qeverisë, të UNMIK-u dhe të ART-së.

Më 10 tetor 2006 Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për përcaktimin e kritereve për licencimin e Operatorit të telefonisë mobile në Kosovë. Ne jemi përcaktuar për metodën e kombinuar dhe minimumi i ofertës ka qenë 20 milionë € e jo 6.5 milionë, siç ka qenë në tenderin e parë dhe kemi përcaktuar kriteret e tjera: kush ofron çmimin më të lartë ka 30% të poenëve, 30% të tjera mbulesa e territorit etj.

Ne kemi kërkuar që procesi të ecë në bazë të procedurave, nuk jemi pajtuar që të ketë zgjatje të afateve të procedurave.

Kur është përmbyllur afati i aplikimit dhe është caktuar Komisioni Vlerësuar, kam kërkuar personalisht nga UNMIK-u që t'i caktojë dy anëtarë të pavarur, dy nga ART-ja dhe Qeveria ka caktuar vetën një anëtar.

Vlerësimi ka përfunduar dhe ART-ja në bazë të mandatit sipas Ligjit e ka shpallur fituesin e parë. Mirëpo, kompania fituese nuk ka arritur të bëjë pagesën në afatin e paraparë, atëherë ART-ja në bazë të kompetencave e ka shpallur fituesin e dytë.

Përfshirja e Qeverisë në këtë proces ka qenë kur ART-ja na ka ftuar që të jemi të pranishëm dhe se duhet ta nënshkruajmë edhe ne licencën.

Jam i bindur që procesi ka qenë transparent dhe në përputhje me ligjin.

Për çdo dyshim që mendon se ka pasur parregullsi në këtë proces e mbështesim çdo auditim të jashtëm, organ kompetent për t'i verifikuar akuzat që bëhen për përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë.

Pas paraqitjes së kryeministrit të Kosovës dhe të kryesuesit të ART-së, kryetari e hapi diskutimin.

Alush Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së tha se e mirëpresim informatën e kryeministrit të Qeverisë të Kosovës dhe të kryesuesit të ART-së. Jemi të hapur edhe për informata të tjera lidhur me këtë çështje, duke respektuar ndarjen e pushteteve.

Nëse opozita nuk është e kënaqur me informatën e Qeverisë dhe të ART-së dhe kërkon që kjo çështje t'i nënshtrohet një auditimi, ne do ta marrim në shqyrtim atë kërkesë dhe do ta mbështesim me përpikëri organizimin kushtetues të vendit – ndarjen e pushtit dhe do ta respektojmë çdo vendim të organeve kompetente.

Jakup Krasniqi, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, - me vëmendje i dëgjova kryesuesin e Bordit të ART-së dhe kryeministrin e Kosovës, z. Agim Çekun.

Ne i kemi ngritur shqetësimet tona, të cilat kërkojmë të verifikohen, për parregullsitë gjatë përgjedhjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë.

Nëse Kuvendi nuk e sheh të arsyeshme që kjo çështje të hulumtohet më thellë, atëherë kërkesat tona reduktohen në një kërkesë të vetme: Kuvendi i Kosovës të marrë vendim për auditimin e procesit të përgjedhëses së operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë nga një agjenci e pavarur dhe e specializuar për këto çështje.

Gjylanze Syla, kryetare e Grupit Parlamentar të AAK-së, - në bazë të informatave të ART-së, të Qeverisë së Kosovës dhe të UNMIK-ut ne konsiderojmë se përgjedhja e operatorit të tytë të telefonisë mobile në Kosovë është e drejtë, transparente dhe e suksesshëm, sepse përfitues janë qytetarët e Kosovës.

I tërë procesi i tenderimit dhe i vlerësimit është zhvilluar në përputhje me ligjin.

Pas kësaj kohe seancën e ka kryesuar **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Deputeti **Nazim Jashari** në emër të Grupi Parlamentar të ORA-s, - ART-ja nuk duhet të jetë mollë sherri ndërmjet pozitës dhe opozitës. Ajo është një agjenci e pavarur, që u përgjigjet të gjithë deputetëve të Kuvendi.

Shqetësuese në tërë këtë proces është se nuk ka pasur transparencë me rastin e hapjes së ofertave. Tenderët hapen publikisht, nuk hapen prapa perdes. Ata zotérinjtë që e kanë hapur atë tender, atë ditë, kanë qenë 5 veta.

Hapja publike nënkupton të mos ketë paqartësi, të mos ketë dilema, të mos lenë vend për dyshime, e që fatkeqësisht ka mbetur vend për dyshime.

Në bazë të këtij tenderi ka qenë e paraparë që ofertës teknike t'i bashkëngjitet edhe një zarf, qëi përban një garacion bankar dhe ka vlerën 20% të vlerës së ofertës. Dhe kompania e parë, e shpallur fituese e tenderit, është treguar e papërgjegjshme, nuk i ka paguar mjetet e nevojshme me kohë. Ajo është dashur të ndëshkohet me 16.2 milion €. Por, garacioni bankar ka qenë i falsifikuar.

Njëri ofertues, në këtë tender, ka qenë i përfshirë në dy konsorciume, kurse në kriteret e tenderit ka qenë e ndaluar që një ofertues të përfshihet në dy ofertime.

Deputeti **Mahir Yagcilar** në emër të Grupit Parlamentar 6 plus, - Nëse dëshirojmë të kemi investime të huaja, atëherë duhet të jemi efikas dhe transparentë për çdo proces të tenderit, sepse vetëm ashtu do të jemi tërheqës për investimet e huaja. Me keqardhje procesi i tenderimit për operatorin e dytë të telefonisë mobile nuk ka kaluar pa ankesa dhe pa probleme.

Shtrohet pyetja se kanë pasur të gjithë tenderuesit dokumentacionin e nevojshëm dhe garacionet financiare për parakualifikim dhe a është paguar depozitimi për t'u radhitur në listë.

Përfaqësuesit e ART-së a kanë mundur të vlerësojnë se cilat kompani janë vërtetë teknikisht dhe finansiarisht të afta për t'i përbushur kushtet e tenderit.

Gjithashtu, vërehet se edhe Ligji për telekomunikacionin ka mangësi. Nuk ekziston bashkëpunim të nevojshëm në mes Ministrisë dhe kryesuesit të AER-së. Nuk ishte dashur të vijmë në situatë që Kosova të vlerësohet si vend ku nuk garantohen investimet dhe ku mungon sundimi i Ligjit.

Deputeti **Ferid Agani** në emër të Grupit Parlamentar për Integrin, - Në mënyrë që të hiqen të gjitha dyshimet për këtë proces, pas shqyrtimit të informatës, plotësuese të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit dhe dëgjimit të fjalës së z. kryeministrit dhe të kryetarit të Bordit të ART-së, jemi të mendimit që Kuvendi i Kosovës ta ftojë Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës për një auditim urgjent të kësaj çështjeje dhe lidhur me të ta përgatisë një raport, që do të jetë subjekt i debatit në këtë Kuvend.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë dhanë edhe këta deputetë: **Emrush Xhemajli, Nekibe Elmendi, Ibush Jonuzi, Bajrush Xhemajli, Xhevati Bislimi, Dritë Statovci, Zef Morina, Besa Gaxheri, Teutë sahatqija, Gani Koci, Behxhet Brajshori, Selvije Halimi, Sanije Aliaj, Hatixhe Hoxha** dhe **Xhelal Canziba**, që janë pjesë e transkriptit.

Në fund të debatit deputeti **Demir Limaj**, në emër të parashtruesve të mocionit, propozoi që Kuvendi i Kosovës të marrë vendim për ta ftuar Auditorin e Përgjithshëm për ta audituar tërë procesin e tenderimit për operatorin e dytë të telefonisë mobile në Kosovë.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e deputetit Demir Limaj. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----	30;
Kundër-----	32;
Abstenime-----	2.

Kryesuesi konstatai: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, nuk e miratoi propozimin e deputetit Demir Limaj.

2. Shqyrtimi i informatës për ngjarjet e 10 shkurtit 2007

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e mocionit ta merrte fjalën.

Deputeti **Emrush Xhemajli** tha se 25 deputetë të Kuvendit të Kosovës më 22 shkurt 2007 patën kërkuar debat në Kuvend për ngjarjet e 10 shkurtit, ku u vranë me armë zjarri dy qytetarë të respektuar të Kosovës, Arben Xheladini dhe Mon Balaj.

Materiali i Ministrisë së Brendshme dhe ai nga dëgjimi parlamentar në Komisionin për Siguri është i mirëseardhur edhe pse kualifikimet në to nuk mund të mbështeten. Nga reporti del se SHPK-ja është e politizuar skajshmërisht. Me këtë polici që kemi nuk ka nevojë për gjykata, ajo i di të gjitha gjërat dhe jep kualifikime politike e gjyqësore.

Me legjislacion të vendit tonë qytetarët, subjektet e ndryshme të organizuara kanë të drejtë të protestojnë për politikat që nuk u pëlqejnë.

Kur ka dhunë të protestuesve ka reagim proporcional nga ana e policisë, por policia në Kosovë ka qenë e parapërgatitur qysh më herët për t'ua dhënë një leksion tragjik protestuesve.

Në asnjë nga informacionet nuk jepet përgjigje për pyetjen konkrete rreth përdorimit të forcës së policisë.

Në raport thuhet se mungon legjislacioni për shkallën e përdorimit të dhunës, pastaj e dyta, Vetëvendosja, asnjëherë nuk ka paraqitur kërkesë për lajmërim të protestave dhe krejt protestat e Vetëvendosjes janë të paligjshme, thuhet në informatën e policisë.

Është e mirëseardhur ajo si shkruhej në materialin e SHPK-së se po përpinqet të ketë metoda dhe përvoja perëndimore, kryesisht metoda Daneze për menaxhimin e protestave publike.

Në raport nuk është thënë asnjë fjalë lidhur me sjelljen e policisë ndërkombëtare kundër protestuesve, e sidomos nuk është sqaruar përgjegjësia e policisë Rumune me 10 shkurt. A kanë komunikuar pjesëtarët e kësaj njësie Rumune me strukturat e Serbisë dhe a ka pasur zotime të mos them marrëveshje lidhur me rrolin e tyre në këto protesta.

Gjykatat e Kosovës, pasi janë lënë me qëllim pa mbështetje financiare dhe pa personel mbrojtës për të qenë të paafta të gjykojnë paanshëm, janë poshtruar duke ua marrë lëndën e Albin Kurtit gjykatat dhe gjykatësit ndërkombëtarë për ta fshehur më lehtë të vërtetën rrëth protestës dhe për të marrë vendime arbitrale që nuk burojnë nga vuillneti i këtij populli.

Z. Kurti praktikisht është i zënë peng dhe po mbahet peng. Cili vend në botë mund të quhet i lirë kur ka të burgosur politikë. Jo z. Kurti, për mendimin tonë ata që e mbajnë në burg duhet të përgjigjen për pengmarrje politike.

Për pikëpamjen tonë menaxhimi i situatës së tashme nuk bëhet me arrestime, dënimë e diferençime ideopolitike, por me veprime konkrete për qetësimin e situatës dhe kjo do të përfshinte në radhë të parë të lirohet z. Albin Kurti, të rikthehen rendi dhe sundimi i ligjit pasi ai nuk ekziston më, të ndalohet veprimtaria antiligjore e policisë për shkatërrimin e organizimeve politike që nuk u pëlqejnë Qeverisë dhe policisë, të krijohet komision hetimor parlamentar për ngjarjet e 10 shkurtit 2006, të bëhet ekspertizë e plotë dhe e paanshme se si ndodhën vrasja dhe plagosja e protestuesve.

E k eqja Kosovës nuk i ka ardhur nga fjala dhe protesta e protestuesve d'uarthatë, por n ga kundërshtari që dihet Serbia – antishqiptare.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Punëve të Brendshme ta merrte fjalën.

Ministri Blerim Kuçi, - Në materialin që e keni para vetes, përvèç informatës për protestën e 10 shkurtit është edhe një raport i Inspektoratit të Policisë edhe një informatë e Shërbimit Policor të Kosovës.

Ministria e Punëve të Brendshme në takimet me Komisarin e Policisë dhe me zëvendësin e tij nga SHPK-ja ka kërkuar rapor të zyrat e policia lidhur me këto ngjarje. Me datën 12 mars 2007 MPB ka marrë një informatë nga policia mbi zhvillimet, planifikimin dhe veprimet e policisë për protestën e 10 shkurtit.

Sipas kësaj informate planifikimi për 10 shkurtin është bërë në bashkëpunim të policisë ndërkombëtare dhe SHPK-së, ndërsa KFOR-i ka pasur një rol të limituar mbështetës.

Inteligjenca ka theksuar se Lëvizja Vetëvendosje ka pasur për qëllim dëmtimin e pronës dhe thyerjen e gardhit. Synimi i policisë ka qenë ndalimi i shkatërrimit masiv të pronës së qytetarëve dhe i lëndimit të oficerëve dhe të demonstruesve. Komanda dhe kontrolli i përgjithshëm i këtij operacioni ka qenë në shtabin qendror të policisë.

Rreth orës 15,20 z. Kurti i ka ftuar demonstruesit t'i largojnë barrikadat. Masa është paralajmëruar nga policia, përmes megafonit, që të mos i largonte barrikadat, por të qëndrojnë mbrapa tyre. Ata refuzuan dhe këmbëngulën të veprojnë sipas urdhrit të Kurtit. Me vrull kanë vozitur kamionin duke thyer barrikadën. Në atë kamion janë gjetur 351 shishe

me ngjyrë, gurë, shkopinj dhe gjësende të tjera janë hedhur mbi policët, që e mbronin portën e ndërtesës qeveritare.

Pajisjet mbrojtëse individuale janë përdorur ndaj masës, por kanë qenë të paefektshme. Gazi lotsjellës është përdorur në një interval prej 2 orësh pa arritur efektin e duhur. Janë përdorur gjithashtu pushkët për projekte plastike. Njësitë policore të Rumanisë dhe të Polonisë kanë qenë të vetmet njësi që kanë pasur pajisje të tilla. Detajet e mëtejme për këtë çështje janë çështje e hetimeve të pavarura.

Si pasojë e këtyre protestave 72 civilë kanë kërkuar përkujdesje mjekësore për lëndime të lehta, 4 prej tyre me lëndime serioze dhe dy nga ata kanë vdekur. Po ashtu edhe 6 oficer të SHPK-së dhe 5 të policisë ndërkombëtare kanë marrë lëndime të lehta, janë dëmtuar dy vutura të OKB-së, një veturë e Ministrisë së Kosovës, dy veturave civile u janë thyer dritaret, si dhe një restoran dhe një butik.

Për shkelje të ligjit janë arrestuar 13 protestues si dhe lideri i Vetëvendosjes z. Albin Kurti. Rasti i tij është në organet e gjyqësisë. Në ndërkohë PSPP-ja ka shpallur kërkime të pavarura për hetimin e rrethanave për lëndimin fatal të Mon Balajt dhe të Arben Xheladinit. Inspektorati i Policisë së Kosovës po i mbikëqyr hetimet.

Zhvillimet pas 10 shkurtit janë karakterizuar me dorëheqjen e ministrit të Punëve të Brendshme, z. Fatmir Rexhepi, e më pas edhe të komisarit të Policisë, z. Stefan Kurtis.

Ministria e Punëve të Brendshme, duke i pasur parasysh të gjithë faktorët që n'dikojnë në gjendjen e sigurisë, i propozon këto

R E K O M A N D I M E

- Rekomandimet e IPK-së të janë bazë për politikat zhvillimore të Shërbimit Policor të Kosovës.
- Të insistohet në transferimin e kompetencave në planin politik prej PSPP-së te Ministria e Punëve të Brendshme dhe ato operacionale prej Policisë së UNMIK-ut tek SHPK-ja.
- Urgjentisht të organizohen trajnime shtesë dhe të pajisen me mjete adekuate pjesëtarët e SHPK-së për ballafaqim me protestat e qytetarëve.
- Duhet inkurajuar dialogun me të gjitha grupet e interesit dhe me ato të pakënaqura për procesin e definimit të statusit.
- Institucionet kosovare dhe faktori politik kosovar duhet t'i bashkërenditin veprimet dhe ato të janë koherente në situatat e ngjashme, kur të rrezikohet situata e sigurisë në vend.

Naim Maloku, kryetari i Komisionit për Siguri të Kuvendit, - Komisioni më 15 shkurt 2007 ka organizuar dëgjim me përfaqësuesit e MPB dhe të SHPK-së. Dëgjimi ka qenë me dyer të myllura.

Komisioni në fund të dëgjimit ka ardhur në këto përfundime: Vlerësojmë lart dorëheqjen e ministrit, Fatmir Rexhepi, si akt moral, që ka ndikuar pozitivisht në zbutjen e tensioneve të krijuara si rrjedhojë e demonstratave. Gjithashtu, Komisioni vlerëson edhe dorëheqjen e komisionarit të Policisë, Stefen Kurtis.

Komisioni kërkon hetime të detajizuara, siç i ka paraqitur në letrat dërguar institucioneve të sigurisë për sjelljen e Shërbimit Policor të Kosovës dhe të Policisë së UNMIK-ut gjatë protestës.

Komisioni është i shqetësuar me përdorimin e plumbave të gomës dhe vlerëson se një përdorim i tillë, sidomos në afërsi, duke vënë në shënjestër kokën dhe pjesët vitale të trupit është e papranueshme. Komisioni gjithashtu, vlerëson si të papranueshme dhe të jashtëligjshme dhunën e shkaktuar nga protestuesit.

Komisioni shpreh besimin tek institucionet e drejtësisë për trajtim të drejtë dhe adekuatë të personave në paraburgim nga Lëvizja “Vetëvendosje” dhe në të njëjtën kohë, për hir të transparencës, kërkon informim nga Ministria e Drejtësisë lidhur me trajtimin e këtyre personave.

Raporti i Inspektoratit Policor të Kosovës është i hartuar në mënyrë profesionale. Nga kjo raport dalin dy çështje: Inspektorati Policor i Kosovës ka bërë hetimet vetëm të sjelljes së Shërbimit Policor të Kosovës, por jo edhe të Policisë së UNMIK-ut.

Nga hetimi i Inspektoratit Policor të Kosovës del se Shërbimi Policor i Kosovës më 10 shkurt ka qenë i paorganizuar dhe në rastin e demonstratave pa komandë të mirëfilltë dhe pa veprim të koordinuar.

Mendimi im personal është, kufizohem nga Komisioni, se Shërbimi Policor i Kosovës nuk ka reaguar fare, pra reagimi i tij ka qenë në panik pasi që masa prej 200, 300 protestuesve ka shpërthyer bë arrikadën e hekurit, pastaj kordonin e policisë dhe përtetës ekonda në atë panik ka përdorur sasi të tepërt të gazit lotsjellës.

Në emër të Komisionit Parlamentar për Siguri i sugjeroj SHPK-së që t'i eliminojë të gjitha dobësitë që janë identifikuar në raportin e Inspektoratit Policor të Kosovës.

Kuvendi sa më parë ta nxjerrë Ligjin për përdorimin e forcës nga policia.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së Alush Gashi,- I mirëpresim fjalën e ministrit të Punëve të Brendshme, raportin e Inspektoratit të Policisë dhe fjalën e kryetarit të Komisionit Parlamentar për Siguri. Kërkojmë nga organet e sigurisë që t'i shtojnë angazhimet në kuadër të mundësive ekzistuese për zbatimin e rekomandimeve, të shtruara nga Komisioni Parlamentar për Siguri.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së Jakup Krasniqi, - Informata e MPB nuk sjell informacione të hollësishme për protestën e 10 shkurtit 2007, ku gjeten vdekjen dy qytetarë dhe u plagosën dhjetëra të tjera. Ne jemi të bindur se kërkesat e protestuesve janë anakronike e paragjykuese për statusin politik të Kosovës. Për faktin se populli i Kosovës ka vetëvendosur për të ardhmen e tij me luftë çlirimtare. Lufta çlirimtare ishte ajo që e krijoi realitetin e sotëm. Kosova tanë po e pret njohjen ndërkombëtare nga OKB-ja dhe KS dhe jemi të bindur se bashkësia ndërkombëtare do të respektojë vullnetin e qytetarëve të Kosovës.

Populli i Kosovës, tanë, për ta realizuar vullnetin e vet politik nuk ka nevojë për protesta të dhunshme. Por, Institucionet përgjegjëse për rend dhe siguri nuk duhet t'i burgosin njerëzit për bindje politike. Ata duhet të lironë nga burgjet.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së Gjylanke Syla – tha se i mbështesin raportin dhe rekomandimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Komisionit Parlamentar për Siguri. Për grupin tonë parlamentar është i papranueshëm përdorimi i plumbave të gomës në pjesët vitale të trupit të protestuesve.

Në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s Teuta Sahatqija – Protestat janë një e drejtë demokratike e cila nuk duhet të ndalohet, por e drejtë në bazë të së cilës qytetarët, grupimet e ndryshme, në mënyrë paqësore e në mënyrë demokratike do të duhej të shprehin mendimet e tyre. Por, nuk jemi të kënaqur me e primin e institucioneve. Përdorimin e dhunës gjatë protestave të 10 shkurtit e konsiderojmë të papranueshëm. Në këtë fazë duhet të dëshmojmë se jemi të pjekur për shtet dhe për sundimin e ligjit. Mendoj që secila anë, në mënyrën e vet, duhet ta japë kontributin e vet për sundimin e ligjit dhe për respektimin e institucioneve.

Deputeti Ramadan Kelmendi – Në ngjarjet e 10 shkurtit 2007 u vranë 2 qytetarë, ministri Fatmir Rexhepi, në shenjë të ndërgjegjes dhe përgjegjësisë që ndjeu, dha dorëheqje. Ishte akti i parë, por shembull shumë i mirë.

Pjesëmarrja në protestat politike si shprehje e pakënaqësive, të cilësdo natyrë qofshin ato, asnjë organi nuk i jep të drejtë, t'ia mohojë e as t'ia marrë jetën ndokujt.

Liria e shprehjes së mendimit politik, tubimeve publike dhe e protestave, janë të rregulluara dhe të garantuara edhe me akte juridike ndërkombëtare, që duhet të zbatohen edhe te ne.

Në emër të Grupit parlamentar për Integrim Numan Baliq – Në ngjarjet e 10 shkurtit 2007, në Prishtinë, nuk kanë qenë përlleshje e thjeshtë ndërmjet policisë dhe protestuesve. Duhet hulumtuar më thellë motivet e pakënaqësisë së asaj mase të njerëzve. Duhet të shihet se nga kush Policia ka marrë urdhra për të shtirë ndaj protestuesve.

Në raport thuhet se dy veta kanë humbur jetën gjatë protestave. Në fakt, janë vrapë dy qytetarë të Kosovës, por mungon ekspertiza mjekësore-gjyqësore për të.

Dhuna ndaj protestuesve është përdorur në mënyrë të paligjshme. Kjo duhet të sqarohet. Grupi i Unitetit dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë është dashur të bisedojnë, paraprakisht, me qytetarët që shprehin pakënaqësi për propozimin e zgjidhjes së statusit të Kosovës, por ata nuk kanë vepruar kështu.

Opinione vërejtje dhe sugjerime lidhur me informatën për ngjarjet e 10 shkurtit 2007 dhanë edhe këta deputetë: **Xhevati Bislimi, Mazlloム Kumnova, Sokol Bashota, Safete Hadërgjonaj, Fetah Berisha, Berat Luzha, Selvije Halimi, Hajredin Hyseni, Hydajet Hyseni, Bajram Kosumi, Gani Koci, Ymer Halimi, Myrvete Dreshaj-Baliu, Sala Berisha-Shala, Ymer Muhamaxheri dhe Sabri Hamiti**, që janë pjesë e transkriptit.

Në fund të debatit ministri, **Blerim Kuçi** i falënderoi deputetët e Kuvendit për kontributin e dhënë dhe iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre.

Deputeti **Emrush Xhemajli**, në emër të parashtruesve të mocionit, kërkoi që Kuvendi ta formojë Komisionin Hetues Parlamentar për t'i hetuar ngjarjet e 10 shkurtit 2007 në Prishtinë.

Kryesuesi seancën e deklaroi të mbyllur në orën 18:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoit

Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale